



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

|                              |                  |                    |
|------------------------------|------------------|--------------------|
| REPUBLICA E KOSOVES          | REPUBLICA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT |                  |                    |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE    |                  |                    |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY       |                  |                    |
| Dep.                         | 2-D/DPK          | Nr. Prot.          |
| Br. Prot.                    |                  | Prot. No.          |
| Nr. i llog.                  |                  | Data               |
| Broj. stranica               | 05               | Datum              |
| Nr. pages                    |                  | Date               |
|                              |                  | PRISHTINE          |

|                        |                                                                                          |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 25.01.2013                                                                               |
| REFERENC-Ë:            | AKK-DPK                                                                                  |
| PËR/ZA/TO:             | z. Driton Pruthi<br>Drejtore i Zyrës së Prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës. |
| CC:                    | z. Arben Gjuka<br>Drejtore i Përgjithshëm i Korporatës Energjetike të Kosovës.           |
| NGA/OD/FROM:           | z. Hasan Preteni<br>Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit                             |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me tenderin "Licencë për Auto Cad dhe Matlad"                             |

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12, dhe neni 19 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159, nenin 19 paragrafi 1 pika 6, dhe neni 12 pika 2.3.4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Licencë për Auto Cad dhe Matlad" me numër prokurimit KEKO-12-039-111 ofron këtë:

### OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejshëm A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Licencë për Auto Cad dhe Matlab" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

### Arsyetim

Zyra e prokurimit në KEK, si autoritet kontraktues, në njoftimin për kontratë të publikuar në UEB faqen e KRPP-së, shpall kontratë "Furnizim" të procedurës së hapur me nr. prokurimit: KEKO-12-039-

111 dhe titull tenderi "Licencë për Auto Cad dhe Matlab" ku ka përgatitur dosjen e tenderit sipas njësisë kërkuese SI.

Njësia e Kërkesës më datë 30.01.2012 ka përgatit kërkesë për Autorizim të Zotimeve dhe ka ndarë mjete për këtë aktivitet të prokurimit në vlerë prej 300,000 €.

Së bashku me kërkesën ka përgatit edhe specifikat teknike për furnizim me licenca për Auto cad dhe Matlab.

Të njëjtat specifika Autoriteti Kontraktues i ka bartë në faqen nr.18 të dosjes së tenderit Aneksi 1 Specifikimet teknike të Detyrueshme.

Siç shihet nga dokumentacioni i kontrolluar njësia e kërkesës me rastin kërkesës për furnizim, nuk ka përgatit kërkesën dhe specifika teknike duke bere ndonjë hulumtim paraprak me të cilën do të konstatohet gjendja reale lidhur me numrin e licencave. Nga kjo shihet se njësia kërkesës në këtë rast SI nuk ka qenë në dijeni rreth nevojave të shfrytëzimit të këtyre programeve në KEK.

Autoriteti Kontraktues fillimisht është dashur të mbledh informata paraprake për nevojat lidhur me këto programe në KEK, numrin e përdoruesve, nivelin profesional të përdoruesve të këtyre licencave e pastaj të kërkohej nga zyra e prokurimit publikimi i njoftimit për kontratë

Tenderi në fjalë është tërhequr nga 11 Operator Ekonomik ndërsa ofertat e tyre i kanë dorëzuar vetëm tre (3) Operator Ekonomik.

Zyra e prokurimit ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderit në përbërje prej tre (3) anëtarëve :

Sipas Komisionit vlerësues për Loton I kishin ofertuar dy (2) operatorë ekonomik ( Citi Computer" SHPK dhe (Stat Gis), të dy Operatoret kishin dokumentacionin e kompletuar dhe pasi që kriter për dhënie të tenderit ishte çmimi më i ulët komisioni propozoj që me kontratë të shpërblehet O.E " City Computer" pasi që kishte çmime më të ulët në vlerë prej 258,208.17 €.

Autoriteti Kontraktues te dosje e tenderit Seksioni II. Fleta e të Dhënave të tenderit (FTD) neni 9.1 Kërkesat mbi mundësit teknike dhe /ose profesionale pika a. Ka kërkuar : Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar ( **të bashkangjitur kopja e marrëveshjes me prodhuesin** ), për shitjen e produkteve që ofroni.

O.E " Citi Computer" SHPK – Prishtinë – i mungonte ( **kopja e marrëveshjes me prodhuesin**) për shitjen e produkteve. Operatori ka ofruar autorizim nga rishitësi IEE ( VAR) , ndërsa ne marrëveshjen e rishitësit me prodhuesin e Autodeskut te lidhur me datën 28.01.2010 ne cila është valide deri me 09 prill te vitit 2012, ndërsa ne faqen numër 5/17, neni 2 pika 2.1 janë te precizuar obligimet e rishitësit me prodhuesin:



## 2 VAR (RISHITËS MË VLERË TË SHTUAR) AUTORIZIMI

2.1 Varësisht nga përmbajtja e VAR ndaj Kërkesave të zbatueshme, Autodesk i jep VAR licencë jo-ekskluzive, jo të transferueshme për të blerë, tregtuar, shpërndarë, shitur dhe mbështetur Produkt-in(et) e Autorizuara të cilat korrespondojnë me Autorizimin e VAR (dhe Tier nëse aplikohet) vetëm për Blerësit. VAR do të ketë të drejtë të marrë pjesë në programin e Beneficioneve në pajtim me Kërkesat e aplikueshme në Udhërrëfyesin e Programit. VAR nuk mund të caktojë, nën-licencojë, delegojë ose nënkontraktojë të drejtat, detyrat apo obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak të shprehur me shkrim nga Autodesk dhe VAR nuk do të angazhohet në ndonjë nën-shpërndarje, marrëveshje me agjenci ose ndërmjetësues në lidhje me Produktet e Autorizuara. Pavarësisht nga kufizimet e mësipërme, VAR mund të lejojë financimin e ndonjë Produkti nga një Përdorues i Fundit nëpërmjet një institucion financiar nëse institucioni i tillë financiar nuk siguron asnjë të drejtë ndaj Produktit të tillë si i licencuari i tij dhe institucioni i tillë financiar nuk rimerr në posedim ose ndryshe të marrë pronësinë e çfarëdo forme të titullit të Produktit të tillë në rast të mos-pagesës nga Përdoruesi i Fundit.

Përveç kësaj, Autodesk mund të zgjedhë për të dorëzuar Produktin direkt për Përdoruesit Përfundimtar me anë të ESD në përpunje me procedurat e tilla të cilat Autodesk mund të caktojë. VAR nuk do të pajtohet apo nuk do të jep pëlqimin për ESD pa marrjen e miratimit nga Autodesk. Produkti do të konsiderohet i përmbushur përmes ESD kur Autodesk ka mundur shkarkimin e tij.

Ne dokumentet e ofruar nuk kemi asnjë marrëveshje të tilla të ofruar nga operatori në fjalë, çka e bën operatorin të papërgjegjshëm.

O.E "Stat Gis" – Prishtinë – i mungon ( **kopja e marrëveshjes me prodhuesin**) për shitjen e produkteve.

Për Loton II kishte ofertuar vetëm një (1) Operator Ekonomik (Eko Invest) komisioni vlerësues pasi që analizoj këtë O.E dhe e shpalli si të përgjegjshëm propozojnë që Loton (I) të anulohet. me arsyetim se janë pranuar më pakë se dy (2) ofertues.

O.E "EKO Invest" nuk kishte dokumentacionin e kompletuar ngase i mungonte ( Sigurimi i tenderit)

Më datë 18.04.2012 ka bërë Njoftimin për Dhënie të Kontratës në Ueb-faqen e KRPP-së me të cilën për Loton I me kontratë shpërblehet O.E " City Computer" me çmime prej 258,208.17 €.

Të njëjtën datë A. K bën njoftimin për anulimin e Aktivitetit të Prokurimit për Loton II " Furnizimi me Licencë Matlab" ngase nuk kishte Operator Ekonomik të mjaftueshëm kishte konkurruar vetëm një (1).

Data e paraparë për nënshkrimin e kontratës ka qenë 30.04.2012, ndërsa më datë 27.04.2012 kemi kërkesën nga Auditori Brendshëm i KEK-ut, për auditimin e aktivitetit të prokurimit, ku zyra e Auditimit kërkon që ky aktivitet i prokurimit të mos procedohet me procedura të mëtutjeshme.



Më datë 03.05.2012 ora 10:04 Operatori Ekonomik “Citi Computers” i drejtohet zyrës së prokurimit për caktimin e një date tjetër për nënshkrimin të kontratës.

Të njëjtën datë Zyra e Prokurimit i përgjigjet Operatorin Ekonomik se posa të jetë gati kontrata do të ju lajmërojmë.

Më 02.07.2012, zyrtari i Auditimit të Brendshëm dorëzon Draft raportin e Auditimit të Brendshëm për furnizim me licencave dhe kërkesën për takim përmbyllës në të cilin do tu njoftojmë me të gjeturat dhe rekomandimet tona.

Më datë 26.09.2012 Drejtori i zyrës Ekzekutive të Prokurimit në KEK jep këtë urdhëresë, ku cekë se ne kemi raportin nga Zyra e Auditimit që rekomandon mos nënshkrimin e kontratës të datës 09.10.2012.

Më datë 26.09.2012 KRPP përgatit Vendimin për Monitorim sipas Kërkesës së Sabri Murati – “City Computer sh.p.k të datës 24.09.2012.

Në bazë të Raportit të Monitorimit të KRPP-së konstatohet:

- Auditimi i aktivitetit të prokurimit nga Auditori i brendshëm i AK- KEK dhe përgjigjja e tij dhe e drejtorit menaxhues ka qenë me afat të gjatë prej 27.04.2012 – 09.09.2012 që do të thotë se janë kaluar të gjitha afatet ligjore dhe si e tillë paraqet shkelje të Ligjit Auditimit Brendshëm.
- Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nga AK – KEK për vonesën e nënshkrimit të kontratës, ka të drejtë ti drejtohet me Ankesë OSHP-së për mos realizimin e nënshkrimit të kontratës.

Më datë 24.10.2012 me nr. 429/12 OSHP-ja i përgjigjet O.E “City Computer- SHPK” – Prishtinë në bazë të shkresës datës 12.08.2012 me të cilën njoftohet OSHP-ja se AK KEK nuk ka nënshkruar kontratën me këtë O.E edhe pse ka bere njoftimin për dhënie të kontratës me datë 18.04.2012.

OSHP pas shqyrtimit të shkresës të prezantuar nga O.E ankues, ekspertizës së KRPP-së dhe opinionëve të saj në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, vlerëson se nuk është kompetence e Auditorit të Brendshëm për anulimin e një aktiviteti të prokurimit.

OSHP-ja konsideron se ndërhyrja e auditorit të brendshëm në këtë rast, është jo ligjore, e pa arsyeshme dhe e pa argumentuar, andaj njofton AK-në dhe O.E ankues, se kontrata duhet të nënshkruhet ngase nuk ekziston kurrfarë baze ligjore për mos nënshkrimin e kontratës.

Më datë 11.01.2013 O.E “City Computer” SHPK parashtroi ankesë pranë OSHP- së për shqyrtim të mëtutjeshëm të këtij Aktiviteti të Prokurimit.

Më datë 14.01.2013 me nr. 05/2013 OSHP-ë nxjerr urdhëresë ku urdhërohet A.K / Korporata Energjetike e Kosovës që ta respektoj propozimin për dhënie të kontratës të publikuar në UEB faqen e KRPP-së me datë 18.04.2012 si dhe ta nënshkruaj kontratën me O.E të shpallur fitues në afat prej 5 ditëve.



Mos respektimi i përgjigjeje me nr. 429/12 të datë 24.10.2012e detyron OSHP-në, konform dispozitave ligjore të nenit 131 LPP-së , ndaj A.K të vendosë një gjobë jo më pak se 5000 €, kurse ndaj Zyrtarit Prokurimit OSHP do të jetë e obliguar në bazë të nenit 25 pika 8 e LPP-së të marr vendim për marrjen e certifikatës së prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit ka evidentuar komunikime jo kompetente lidhur me implementimin e këtij projekti:

Më datë 04.12.2012 Sabri Murati kërkon nga Zyrtari prokurimit kërkon caktimin e një date për nënshkrimin e kontratës dhe na jepni një përgjigjeje për mos ftesën e nënshkrimit të kontratës ngase ju jeni të informuar rreth vendimeve të marra nga KRPP dhe OSHP rreth kësaj kontrate.

Më datë 10.12.2012 ( Edmond Nulleshi), në lidhje me këtë çështje ju ftojme nesër, në ora 15:00 në një takim me zyrën time në Ndërtesën e Elektrokosoves kati VI. Shpresojmë se do të gjejmë një gjuhë të përbashkët se si të procedojmë me këtë çështje në mirëkuptim.

Më datë 10.12.2012 ora 12:57 (Sabri Murati) desha të theksoj se nuk di se çka do të jetë biseda rreth këtij projekti kur i dimë të gjitha vendimet e KRPP-së dhe OSHP-së rreth këtij projekti. Por ok, do të takohemi, por nëse ka mundësi nesër (11.12.2012) në ora 10:00 paradite, nëse jo do të vi në ora 15:00.

Më 10.12.2012 ( Edmond Nulleshi), nesër kam disa takime të caktuara me herët, andaj ju lus që te vini në ora 15:00.

Më 10.12.2012 (Sabri Murati) në rregull atëherë shihemi në ora 15:00.

Më 13.12.2012 (Edmond Nulleshi) Ju faleminderit për takimin që patëm të martën e kaluar. Si edhe që diskutuam në takim, duke marr parasysh proceset neper të cilat është duke kaluar KEK-u, ju lutem që të na mundësoni që kontrata në fjalë të ekzekutohet në këtë formë:

- Furnizimi i 10 (dhjetë) licencave Auto Cad Civil 3D dhe 25 ( Njëzetepesë) licenca Auto Cad Elektrik të bëhet më 30.06.2013, ndërsa pagesa të bëhet pas liferimit brenda afatit respektiv.
- Furnizimi me pjesë tjera të licencave të bëhet brenda afatit pas nënshkrimit të kontratës të përcaktuar ne dosjes e tenderit.

Agjencia kundër Korrupsionit në dokumentacionin e ekzaminuar, vlerësuar dhe krahasuar vjenë ne përfundim së:

**Autoriteti Kontraktues ka kërkuar vlefshmërinë e ofertave 90 ditë kalendarik të cilën vlefshmëri e kanë ofruar të gjithë Operatorët Ekonomik Ofertues, mirëpo pasi që lënda është e tej zgjatur Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar nga Operatorët ekonomik zgjatjen e validitetit të ofertave , kështu që në këtë raste të gjithë ofertat janë jo valide gjë që A.K ka bere shkelje të nenit 28 pika 3 e Udhëzuesit Operativ.**

Me respekt!